Te ardhurat nga interesi njihen sic ato realizohen duke perdorur metoden e interesit efektiv (EIR). Interesi efektiv eshte norma qe saktesisht zbret flukset e ardhshme te vleresuara gjate jetes se pritshme te instrumentit financiar ose nje periudhe me te shkurter, kur eshte e pershtatshme ne vleren kontabel neto te aktivit financiar. Te ardhurat nga interesi jane te perfshira ne te ardhurat financiare ne pasqyren e fitimit ose humbjes.

2.17 Pagesat e qirase

Qirate klasifikohen si qira financiare kur kushtet e qiras transferojne ne menyre domethenese te gjitha risqet dhe perfitimet e pronesise tek qiramarresit. Te gjitha qirate e tjera klasifikohen ne qira operative. Pagesat e bera per qirane jane paraqitur ne pasqyren e te ardhurave ne baze lineare pergjate kohezgjatjes se kontrates. Shoqeria ka hyre ne marreveshje qiraje per prone

tregtare, dhe ka percaktuar, bazuar ne vleresimet kushtet e marreveshjes, ku zoteron te gjitha risqetdhe perfitimet mbi keto prona dhe per kete arsye i konsideron ato si qira operative

Shoqeria si qiramarrese

Qirate financiare qe transferojne rrezikun dhe perfitimet ne menyre aksidentale tek shoqeria, jane kapitalizuar si nje fillim i ri i qirase me vleren e drejte te prones se dhene me qira, ose ne qofte se eshte me e vogel me vleren aktuale te minimumit te pagesave te qirase. Pagesat e qirase jane te ndara midis pagesave financiare dhe uljes se detyrimit ndaj qirase, per te arritur ne nje nivel konstant te interesit ne tepricen e mbetur te detyrimit. Pagesat financiare jane njohur si kosto financiare ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Nje aktiv i dhene me qira eshte amortizuar gjate jetes se dobishme te tij. Megjithate, me qene se shoqeria nuk ka nje siguri qe do ta zoteroje pronesine ne fund te kohezgjatjes se qirase, aktivi do te amortizohet per nje periudhe me te vogel se jeta e dobishme e tij. Pagesat e qirase operative jane njohur si shpenzime operative ne pasqyren e te ardhurave ne menyre lineare gjate kohezgjatjes se qirase.

Shoqeria si qiradhenes

Qirate ku shoqeria nuk transferon konsiderueshem risqet dhe perfitimet e pronesis te nje aktivi jane klasifikuar si qira operative. Kostot direkte fillestare te ndodhura per pershtatjen e ambjenteve sipas kerkeses se qiramarresit te nje qiraje operative i shtohen shumes se aktivit te dhene me qira dhe njihen ne te njejten baze si te ardhura nga qiraja. Qirate e ndara do te njihen si te ardhura ne periudhe ne te cilen jane perfituar.

Depozitimet e qiramarresit

Detyrimet per depozitim te qiramarresit njihen fillimisht me vleren e drejte dhe ne vazhdim me koston e amortizuar kur ka vlere materiale. Cdo diference midis vleres se drejte fillestare dhe vleres nominale perfshihet si nje e ardhur komponent te qirase operative dhe njihen ne menyre lineare pergjate gjithe termave te qirase.

2.18 Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara.

2.19 Te ardhurat dhe shpenzimet finaciare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

2.20 Kostot e huave

Kostot e huave te lidhura direkt me blerjen, dertimin ose prodhimin e aktiveve, te cilat duan nje kohe te gjate per tu sjelle ne forme perfundimtare, ne menyre qe te perdoren apo shiten, i shtohen kostos se ketyre aktiveve, deri ne momentin kur keto aktive jane gati qe qellimin e tyre per perdorim ose per shitje. Te ardhurat nga investimet e perkohshme, per sa i perket disa huave te vecanta, te cilave ende nuk iu eshte paguar interesi, kjo shume ju zbritet kostove te huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos se aktivit.

Te gjitha kostot e tjera njihen si te ardhura ose shpenzime ne periudhen kur ato kane ndodhur.

2.21 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet qe lidhen

me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.
Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne diten e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Shoqeria njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm pët të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2.22 Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e perdorur dhe raportuese
Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne Leke (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Shoqerise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet
Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Gjate pergatitjes se pasqyrave financiare, transaksionet ne monedhe tjeter nga monedha funksionale (monedha te huaja) regjistrohen me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Ne fund te cdo periudhe raportuese, mjetet monetare ne monedhe te huaj rivlersohen me kursin e dates se raportimit. Mjetet jo monetare qe mbahen me vlere te drejte regjistrohen ne monedhe te huaj dhe rivlersohen me kursin e dates kur percaktohet vlera e drejte. Mjetet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj nuk rivlersohen.

Kurset e kembimit me date 31/12 sipas kursit te Bankes se Shqiperise jane:

	31 Dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Euro	123.42	132.95
USD	107.82	111.10

2.23 Standartet dhe amendimet e reja ose te ndryshuara

Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.

a) SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 "Të ardhurat", "SNK 11 Kontratat e ndërtimit", dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat. Standardi i ri krijon një model njohjeje me bazë kontrolli të ardhurave dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në mënyrë të detajuar nga SNRF-ve ekzistuese, duke përfshirë mënyrën për njohjen e marrëveshjeve me detyrime të shumta të performancës, çmime të ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të konsumatorit, opsionet e riblerjes, dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

Kontabilizimi i te ardhurave qe rezultojne nga kontratat me klientet behet duke perdorur nje model me pese hapa:

- Identifikimi i kontrates me nje klient
- Identifikimi i detyrimeve te performances ne kontrate
- Percaktimi i cmimit te transaksionit
- Shperndarja e cmimit te transaksionit ndaj detyrimeve te performances ne kontrate, dhe
- Njohja e te ardhurave kur njesia ekonomike permbush nje detyrim te performances

Sipas SNRF 15, parimi baze eshte qe nje njesi ekonomike do te njohe te ardhurat ne nje shume qe reflekton shumen ne te cilen njesia ekonomike pret te kete te drejten ne kembim te transferimit te sherbimeve per nje klient.

Ndryshimet kryesore nga praktika aktuale:

- Cdo mall apo sherbim i premtuar, i cili eshte i dallueshem, duhet te njihet me vete, dhe cdo zbritje mbi cmimin e kontrates, ne pergjithesi duhet te shperndahet mbi elementet e vecante.
- E ardhura mund te njihet me heret sesa sipas standarteve aktuale nese vleresimi ndryshon per ndonje arsye (sic mund te jene incentivat, ulje te tjera, tarifat e performances, honoraret, suksesi i nje rezultati etj.) shuma minimale duhet te njihet nese ato nuk perbejne nje risk te rendesishem kthimi.
- Momenti ne te cilen e ardhura eshte e mundur te njihet mund te zhvendoset: disa te ardhura te cilat aktualisht jane njohur ne momentin e perfundimit te kontrates, mund te dyhen te njihen gjate kohezgjatjes se kontrates ose e kunderta.
- Ka rregulla specifike mbi licensat, garancite, tarifave fillestare te parimbursueshme dhe marreveshjet e ndermjetesimit, sa per te permendur disa.

SNRF 15 hyri në fuqi në periudhat raportuese vjetore që filluan më ose pas 1 janar 2018.

b) SNRF 9 "Instrumentet Financiare"

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime të mëdha në udhezimet e SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe prezanton një model të ri "humbje krediti të pritshme" për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Gjatë adoptimit të SNRF 9, shoqëria ka aplikuar lehtësim në tranzicion dhe ka vendosur të mos ripërtërijë periudhat paraprake. Diferencat që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në lidhje me klasifikimin, matjen dhe zhvlerësimin njihen në fitimet e pashpërndara.

SNRF 9 gjithashtu përmban kërkesa të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.Kërkesat e reja kërkojnë të harmonizojnë më shumë kontabilitetin mbrojtës me aktivitetet e administrimit të rrezikut të njësive duke rritur mundësinë e depozitave të mbrojtura dhe instrumenteve mbrojtës dhe duke paraqitur një qasje më të bazuar në parime për të vlerësuar efektivitetin mbrojtës. Shoqëria zbaton kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës në mënyrë prospektive dhe të gjitha mbrojtjet kualifikohen për t'u konsideruar si marrëdhënie mbrojtëse të vazhdueshme.

Miratimi i SNRF 9 ka ndikuar fushat e mëposhtme:

- klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të Shoqërisë. Drejtimi ka aktive financiare për të mbajtur dhe mbledhur flukset monetare. Obligacionet e klasifikuara më parë si investime të mbajtura në maturim (HTM) sipas SNK 39 vazhdojnë të kontabilizohen me koston e amortizuar (AC) pasi ato plotësojnë detyrimet e mbajtura për të mbledhur sipas modelit të biznesit dhe testin e karakteristikave të flukseve monetare kontraktuale në SNRF 9.
- Shoqëria ka zgjedhur që në mënyrë të pakthyeshme të përcaktojë investimet e reja në letrat me vlerë të klasifikuar me parë si të disponueshme për shitje (AFS), sipas SNK 39 tani me vlerën e drejtë me ndryshimet e paraqitura në të ardhurat e tjera përmbledhëse.
- zhvlerësimi i aktiveve financiare duke zbatuar modelin e pritur të humbjes së kredisë. Kjo ndikon në llogaritë e arkëtueshme tregtare të shoqërisë dhe investimet në aktivet e tipit të borxhit të matura me koston e amortizuar.

Në datën e aplikimit fillestar, më 1 janar 2018, instrumentet financiare të shoqërisë për efektet e riklasifikimit analizohen si më poshtë.

Kategoria e Aktiveve Financiare	**Klasifikimi SNK 39**			**Matja SNRF 9**	**Konkluzioni**
Mjete monetare	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI	AC	Nuk ka impakt
Llogari/Kerkesa te arketueshme	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI	AC	Nuk ka impakt
Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI	AC	Nuk ka impakt

Shoqëria ka vendosur të mos riparaqesë informacionin krahasues në zbatimin fillestar të SNRF 9. Zbatimi i SNRF 9 dhe ndryshimi i politikës kontabël për ndikimin e bilancit fillestar të Shoqërië më 1 janar 2018 paraqitet në tabelën në vijim. Në datën e aplikimit fillestar, më 1 janar 2018, instrumentet financiare të shoqërisë për efektet e matjes analizohen si më poshtë.

Aktivet	**31 dhjetor 2017**	**Riparaqitje e balancavehapëse**	**1 janar 2018**
Mjete monetare	248,546,471	-	248,546,471
Llogari/Kerkesa te arketueshme	2,939,509,006	-	2,939,509,006
Aktive Financiare afatshkurtra	1,183,846		1,183,846
Parapagimet & Shpenzimet e shtyra	844,508,590		844,508,590
Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	5,811,439	-	5,811,439
Total	4,039,559,352	-	4,039,559,352

Shoqëria zbaton një model të thjeshtëzuar të njohjes së humbjeve të pritshme të kredise, llogaritë e arkëtueshme tregtare të shoqërisë te tjera te arketushme të matura me koston e amortizuar dhe vlereson se nuk një ndikim të rëndësishëm finananciar në datën e aplikimit fillestar të standardit.

2.24 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, si dhe ndryshime të standardeve ekzistuese, që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria, janë publikuar nga BSNK. Informacion mbi ato standarde që pritet të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë është dhënë më poshtë. Drejtimi pret që të gjitha standardet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Shoqërisë për periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet

të cilat nuk janë miratuar apo të shënuara më poshtë nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF 16 "Qiratë"
SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse. Kjo kompleton projektin e gjatë e BSNK-së për të rishikuar të kontabilitetin e qirave. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një të drejte përdorimi të një aktivi dhe të një detyrimi qiraje. SNRF 16 hyn në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin e plotë të Standardit dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të japë informacion sasior. Megjithatë, për të përcaktuar ndikimin Shoqëria është në proces të:

- kryerjes së një rishikimi të plotë të të gjitha marrëveshjeve ekzistuese dhe për të vlerësuar nevojen e ndonjë amendimi te kontratave, ne menyre qe te jete ne perputhje përkufizimin e ri SNRF 16.
- përcaktimit të dispozitave kalimtare që do të miratojë; aplikimin e plotë retrospektiv ose aplikimin e pjesshëm retrospektiv (që do të thotë informacioni krahasues nuk duhet të riparaqitet). Aplikimi i metodës së pjesshme jep gjithashtu një opsion lehtësimi për rivlerësimin nëse kontratat ekzistuese janë, ose përmbajnë, një qira, si edhe lehtësime të tjera. Përcaktimi se cilët nga këto praktika do të miratohen është i rëndësishëm pasi ato janë zgjedhje të pakthyeshme
- vlerësimit të informacioneve shpjeguese të saj aktuale për qiratë financiare dhe qirave operative pasi këto kanë të ngjarë të formojnë bazën e shumave që do të kapitalizohen dhe të bëhen të drejta përdorimi të aseteve
- përcaktimin se cilat thjeshtëzime opsionale kontabël do të zbatohen për portofolin e tyre të qirasë dhe nëse se do të përdoren përjashtime
- vlerësimit të sistemit të IT dhe nëse nevojitet një sistem të ri leasing. Kjo është duke u konsideruar në përputhje me zbatimin e SNRF 15 dhe SNRF 9 në mënyrë që Shoqëria vetëm t'i nënshtrohet një sërë ndryshimesh të sistemit njëhkohësisht
- vlerësimit për dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë që do të nevojiten.

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre.
Shoqëria planifikon të miratojë SNRF 16 më 1 janar 2019 duke përdorur metodën e modifikuar të paraqitjes retrospektive të Standardit. Sipas kësaj qasjeje, efekti kumulativ i zbatimit fillimisht të SNRF 16 njihet si një rregullim në kapital në datën e aplikimit fillestar. Informacioni krahasues nuk riparaqitet.

Zgjedhja e kësaj qasjeje të tranzicionit rezulton në vendime të mëtejshme të politikave që shoqëria duhet të bëjë pasi ka disa lehtësime të tjera kalimtare që mund të aplikohen. Këto lidhen me ato qera të mbajtura më parë si qera të zakonshme dhe mund të aplikohen në bazë të analizimit të cdo kontratë. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e zbatimit të këtyre lehtësimeve të tjera kalimtare.

3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit

Çelja e vitit 2018 rakordonte me mbylljen e vitit 2017.

4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Aktivet monetare perfshijne vlerat ne arke e banke, investime afatshkurtra qe jane shume likuide dhe te konvertueshme ne vlera te njohura monetare dhe vetem me nje humbje jomateriale ne vlere monetare.

Aktivet monetare ne bilanc i korrespondojne vlerave te mjeteve monetare te percaktuara si me siper dhe detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Arka	19,342,436	6,946,905
Banka	86,991,667	240,299,566
Letra me vlere	1,300,000	1,300,000
Totali	**107,634,103**	**248,546,471**

5. Inventare

Ne tabelen e meposhtme, paraqiten detajet ne lidhje me kategorite e inventareve me 31.12.2018 dhe 31.12.2017:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Materiale te para	98,277,076	50,264,188
Mallra	611,516,037	628,557,261
Parapagesa per furnizime	62,477,406	122,640,725
Totali	**772,270,519**	**801,462,174**

6. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe Shpenzime te shtyra perfaqesojne shpenzimet per projekte dhe taksa te objekteve ne process ndertimi per vete dhe per te tretet.

Ne tabelen e meposhtme, paraqiten detajet ne 31.12.2018 dhe 31.12.2017:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Shpenzime te projekteve ne ndertim	654,853,353	652,320,553
Shpenzime te projekteve te pafilluara	28,908,479	191,353,428
Garanci qeraje	61,513	834,609
Totali	**683,823,345**	**844,508,590**

7. Llogari te arketueshme (Klientet)

Nje prezantim sipas kategorive te klienteve ne 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 paraqitet

si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Objekte ne Ndertim	1,444,540,085	616,419,633
Kliente nga shitja e objekteve	-	47,076,605
Kliente tendera ndertimi	3,001,360,613	2,053,230,244
Kliente (ABA + Toptani)	144,645,689	165,373,387
Kliente Coin	21,461,225	39,363,023
Kliente te tjere	10,089,005	18,046,113
Totali	**4,622,096,615**	**2,939,509,005**

8. Te tjera te arketueshme

Llogari te tjera te arketueshme per gjendjen e tyre me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017, paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Garanci Rentat Minerare	5,361,849	5,361,849
Te Arketueshme te tjera	4,590,941	449,590
Totali	**9,952,790**	**5,811,439**

9. Aktive afatgjata materiale

Shoqeria ka nje vlere neto te aktiveve afatgjata materiale 5,933,852,213 leke dhe eshte vleresuar me koston e marjes se tyre zbritur amortizimin. Ne tabelen e meposhtme, jane paraqitur detajet per levizjet e aktiveve afatgjata materiale dhe amortizimin sipas kategorive, per 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017:

	Toka	Ndertesa & Instalime	Makineri & Pajisje	Mjete Transporti	Aktive te Tjera	Totali
Aktive te Trupezuara						
Gjendje 01.01.2018	868,820,270	4,551,499,217	1,110,804,373	310,299,892	459,119,330	7,300,543,083
Shtesa	2,161,000	6,446,280	297,315,369	30,540,179	296,643,988	633,106,817
Pakesime	-	-	(237,000)	-	-	(237,000)
Gjendje 31.12.2018	**870,981,270**	**4,557,945,497**	**1,407,882,742**	**340,840,071**	**755,763,318**	**7,933,412,900**
Amortizimi						
Gjendje 01.01.2018	-	550,519,658	603,734,342	145,658,099	279,788,437	1,579,700,536
Amortizimi i AAM i vitit 2018	-	200,158,963	120,569,133	34,178,529	64,953,525	419,860,150
Pakesimi i Amortizimit 2018	-	-	-	-	-	-
Gjendje 31.12.2018	**-**	**750,678,621**	**724,303,475**	**179,836,628**	**344,741,962**	**1,999,560,686**
Vlera neto 01.01.2018	868,820,270	4,000,979,559	507,070,031	164,641,793	179,330,893	5,720,842,547
Vlera neto 31.12.2018	**870,981,270**	**3,807,266,877**	**683,579,267**	**161,003,443**	**411,021,356**	**5,933,852,213**

Amortizimi i Aktivevé afatgjata materiale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat" ne vlere 419,860,150 leke, vlere e cila eshte njohur ne shpenzimet e vitit.

10. Aktive afatgjata jomateriale

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Program kompjuterik - Vlera Bruto	6,364,167	6,364,167
Amortizim i Akumuluar	(5,627,441)	(5,259,079)
Amortizim i Vitit	(184,181)	(368,362)
Vlera Neto	**552,546**	**736,727**

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat" ne vlere 184,181 leke, vlere e cila eshte njohur ne shpenzimet e vitit.

11. Huate afatshkurtra

Huate afatshkurtra perbehen nga shuma e overdrafteve dhe kredite afatshkurtra marre nga bankat e nivelit te dyte ne Shqiperi. Detajet per gjendjen me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Overdraftet	1,238,436,773	665,609,468
Pjesa Afatshkurter e Huase Afatgjate	0	0
Hua Afatshkurtra	0	16,899,227
Totali	**1,238,436,773**	**682,508,695**

12. Detyrime ndaj shtetit

Detyrime ndaj shtetit perfaqeson kryesisht shumen e detyrimeve per sigurimet shoqerore & shendetesore si dhe tatimin mbi te ardhurat personale, qe i perkasin pagave te muajit dhjetor 2018. Keto detyrime jane paguar sipas dispozitave ligjore ne Janar 2019. Gjithashtu detyrimi per tatim fitimin eshte paguar ne 3-mujorin e pare te vitit 2019.

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Sigurime shoqerore	11,107,237	8,785,057
Tatim Page	1,772,019	1,457,847
TVSH	(0)	2,850,406
Tatim Fitimi	11,910,854	2,387,949
Tatim ne burim	2,329,377	9,690,079
Taksa Vendore	22,463,359	22,294,221
Totali	**49,582,845**	**47,465,559**

13. Te tjera detyrime afatshkurtra

Te tjera detyrime afatshkurtra, perfaqesojne pagat per t'u paguar qe i perkasin muajit dhjetor 2018, te cilat jane paguar ne Janar 2019.

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Te Pagueshme ndaj Punonjesve	38,981,658	32,389,530
Totali	**38,981,658**	**32,389,530**

14. Shitjet neto

Shoqeria per vitin 2018 ka realizuar shitje neto, detajuar si me poshte :

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Shitje produkt i gatshem	79,359,909	105,171,821
Shitje mallra qendra tregtare	733,248,340	741,407,232
Shitje ndertimi objekte banimi	882,235,783	998,614,411
Shitje ndertimi per te trete	4,042,055,026	5,746,029,245
Te tjera shitje materialesh	125,633	3,611,067
Totali	**5,737,024,691**	**7,594,833,775**

15. Te ardhura te tjera

Shoqeria per vitin 2018 ka realizuar te tjera shitje e sherbime, detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Qerate & sherbim Qendrat e Biznesit	1,001,597,912	872,000,806
Qera Veshjesh + Komisione Coin	7,042,468	7,369,911
Shitje AAM	6,944,310	4,296,752
Te Ardhura te Tjera	1,791,530	2,398,766
Totali	**1,017,376,219**	**886,066,234**

16. Mallra lende te para dhe sherbime

Ne kete ze perfshihen shpenzimet per lende te para, taksa doganore e shpenzime transporti per lemdet e para dhe mallrat dhe shërbime ndertimore nga te trete, detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Shpenzime Materiale	3,399,221,464	4,390,574,050
Punime nga Nenkontraktoret	586,689,264	1,437,788,955
Mallra per shitje (Coin)	549,772,868	539,135,436
Totali	**4,535,683,597**	**6,367,498,441**

17. Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet, detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Shpenzime energjie	127,508,750	105,749,129
Shpenzime qeraje	197,100,649	112,419,073
Mirmbajtje dhe riparimi	97,699,322	104,494,425
Prime te sigurimit	35,510,609	29,750,600
Udhetim & hoteleri	69,353,205	49,846,879
Sherbime te tjera	171,483,123	357,802,224
Reklama Publicitet	61,246,357	39,269,148
Shpenzime postare, telekomunikac, transport	22,896,414	23,438,489
Sherbime bankare	8,482,742	17,788,416
Taksa	85,756,066	66,933,281
Penalitete & shp. me dok.jo te regullta	20,641,313	3,267,811
Sponsorizime& dhurata	5,318,220	2,459,496
Vlera kontabel AQT te shitura	6,998,725	8,524,093
Totali	**909,995,495**	**921,743,063**

18. Shpenzime te personelit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore, detajuar si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Paga	405,702,614	340,714,533
Sigurime shoqerore	67,183,793	56,720,064
Totali	**472,886,407**	**397,434,597**

19. Amortizimi dhe zhvleresimet

Amortizimi i Aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te Ligjit Nr. 8438, date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat".

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Amortizimi i AAM (shiko noten 9)	419,860,150	359,690,057
Amortizimi i AAJM (shiko noten 9)	184,181	368,362
Totali	**420,044,331**	**360,058,419**

20. Te ardhura dhe shpenzime nga interesi

Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesi, per vitin ushtrimor 2018 dhe 2017, paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Te ardhura nga interesat	54,232	61,773
Shpenzime per interesa	(48,622,586)	(27,503,783)
Totali	**(48,568,354)**	**(27,442,010)**

21. Fitim / humbjet nga kursi i kembimit

Fitim / humbjet nga kursi i kembimit, per vitin ushtrimor 2018 dhe 2017, paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Fitime nga kembimet valutore	151,873,218	103,167,079
Shpenzim nga kembimet valutore	(102,589,460)	(126,943,324)
Totali	**49,283,758**	**(23,776,245)**

22. Llogaritja e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatim fitimit jane llogaritur sipas dispozitave ligjore tatimore ne daten e mbylljes se bilancit. Detajet e llogaritjeve jane paraqitur ne tabelen e meposhtme:

	31 Dhjetor 2018	*31 Dhjetor 2017*
Fitimi Bruto	416,758,470	389,632,635
Humbje e mbartur	0	0
Shpenzime te pa njohura	20,907,858	3,519,774
Baza e llogaritjes Tatimit	437,666,328	393,152,410
% e Tatim Fitimit	15%	15%
Tatim Fitimi	**65,649,949**	**58,972,861**
Fitimi NETO	**351,108,521**	**330,659,774**

23. Vijimesia

Pasqyrat financiare te kompanise Gener 2 sh.p.k per vitin financiar 2018, jane pergatitur sipas parimit te vijimesise, qe do te thote se veprimtaria ekonomike e kompanise do te kete vijimesi, dhe Gener 2 shpk, nuk ka ne plan ose nuk do ta kete te nevojshme ta nderprese aktivitetin e saj.